



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

LEGJISLATURA V
Sesioni pranveror

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë së Kosovës
Mbledhja nr. 9
Prishtinë, më 11.3.2015, në orën 11:00
Ndërtesa e Kuvendit, salla S-I

PROCESVERBAL
I MBLEDHJES SË KOMISIONIT PËR PUNË TË BRENDSHME, SIGURI DHE
MBIKËQYRJE TË FORCËS SË SIGURISË SË KOSOVËS

Në mbledhje morën pjesë: Daut Haradinaj- kryetar, Fadil Demaku, Ganimete Musliu, Anton Quni, Rexhep Selimi, Nuredin Ibishi, Zafir Berisha dhe Qerim Bajrami-anëtarë.

Mungoi: Anton Quni dhe Bojan Mitiq.

Të ftuar dhe pjesëmarrës të tjerë: Ardiana Gashi-OSBE; Lumnije Murati- Zyra e Presidentes së Kosovës; Krenare Loxhaj- QKSS dhe Luanda Domi-DCAF.

Nga Staf i Mbështetës i Komisionit: Nur Çeku dhe Zarife Aliu.

Mbledhjen e kryesoi, kryetar i Komisionit.

Në këtë mbledhje u propozua ky

Rend i ditës:

1. Miratimi i rendit të ditës;
2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit të mbajtur më 24.02.2015;
3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-02 për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit;
4. Mbikëqyrja e zbatimit të Ligjit Nr. 04/L-076 për Policinë;
5. Të ndryshme.

Kryesuesi konstatoi se janë plotësuar kushtet për fillimin e punës dhe e hapi mbledhjen.

1. Miratimi i rendit të ditës

Rendi i ditës u miratua pa ndryshime.

2. Miratimi i procesverbalit të mbledhjes së Komisionit të mbajtur më 24.02.2015;

Procesverbali i mbledhjes së Komisionit të mbajtur më 24.02.201 u miratua pa vërejtje.

3. Shqyrtimi i Projektligjit Nr. 05/L-02 për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit.

Kryetari- Fillimisht theksoi se Projektligji ka kaluar të gjitha procedurat gjithashtu edhe nga ana komisioneve kryesore janë sjellë rekomandimet lidhur me projektligjin dhe sot është për miratim në Komision, prandaj vlerësoi se sot duhet votuar raporti për projektligjin dhe më pas të procedohet për seancë.

Gjithashtu njoftoi se nga ana zyrës për propozim dhe parashtrës të Kuvendit, është vlerësuar që amendamentet e propozuara nga z. Rexhep Selimi janë paraqitur jashtë afatit kohor që parashihet nga rregullorja e Kuvendit, ndërsa është pranuar i pjesshëm propozimi i deputetit Zafir Berisha. Propozimi i z. Berisha do të shkojë në seancë dhe është pa përkrahjen e Komisionit. Gjithashtu theksoi se në seancë z. Rexhep Selimi ka të drejtë të mbrojë qëndrimet e veta. Nëse nuk keni për të shtuar e kishim votuar raportin e projektligjit.

Zafir Berisha- Theksoi se për propozimi-amendamentin që ka bërë për Nenin 1, nga takimi i kaluar u dakordua që të hiqet pjesa e parë e propozim-amendamentit dhe të mbetet vetëm pjesa “Qeveria e Kosovës i cilëson luftërat okupuese ose aktivitete terroriste konfliktet e caktuara” kjo u votua dhe ishim dy persona për. Në raport kemi versionin e parë, por sidoqoftë edhe në këtë formë do ta mbrojë në këtë version në seancë.

Rexhep Selimi- Theksoi se pas votimit të amendamenteve që janë bërë, në këtë takim Komisioni duhet të votojë raportin dhe t’i rekomandojë Kuvendit miratimin ose jo të këtij projektligji. Pra, për çështje procedurale, duhet të kërkohet nga ne që të votojmë dhe t’ia rekomandojmë seancës.

Ndërsa sa i përket propozim-amendamenteve të bëra shprehi mirënjohje për mirëkuptimin nga ana e anëtarëve të Komisionit, pasi në një fazë jo të duhur kohore dhe procedurale janë diskutuar këto rekomandime. Por, theksoi se këto propozim-amendamente do t’i prezantojë në seancë në përputhje me rregulloren e Kuvendit, dhe kur të kërkohet vota ime për t’i rekomanduar seancës, sipas qëndrimit tim dhe grupit parlamentar të Vetëvendosjes nuk do të votojmë këtë projektligj.

Kryetari- Nëse nuk keni çështje të tjera, propozo të votojmë raportin e projektligjit dhe t’i rekomandojmë seancës miratimin e tij.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në këtë pikë të rëndit të ditës me gjashtë vota për(Daut Haradinaj, Fadil Demaku, Nuredin Ibishi, Ganimete Musliu, Qerim Bajrami, Zafir Berisha) dhe një kundër(Rexhep Selimi) nxori këtë:

PËRFUNDIM

I rekomandohet Kuvendit miratimi i Projektligjit Nr. 05/L-02 për ndalimin e bashkimit në konflikte të armatosura jashtë territorit të vendit.

Gjithashtu propozoi të hidhet në votime dhe propozim-amendamenti i z. Zafir Berisha, ku me katër vota kundër(Fadil Demaku, Nuredin Ibishi, Ganimete Musliu, Qerim Bajrami), dy vota për(Daut Haradinaj, Zafir Berisha), një abstenim(Rexhep Selimi), u votua propozim-amendamenti i z. Berisha.

Gjithashtu, në legjislaturën e kaluar, Komisioni ka bërë një projektligj për Komisionarin për FSK-në dhe PK-në. Kjo është praktikë e vendeve perëndimore për të mbrojtur të drejtat e personave të armatosur. Për shkak të shpërbërjes së Kuvendit, ky projektligj nuk është miratuar, prandaj propozoi formimin e grupit punues për shqyrtimin e këtij projektligji. Presim mbështetje nga legjislatura e tanishme.

Rexhep Selimi- Edhe pse nuk është përfshirë në rendin e ditës, theksoi se e mbështet formimin e grupit punues për projektligjin për Komisionarin për FSK-në dhe PK-në. Gjithashtu shtoi se është projektligj me nismën e Komisionit dhe anëtarët e Komisionit kanë qenë hartues. Në legjislaturën e kaluar, ka kaluar leximin e parë, është amendamentuar, por për shkak të shpërbërjes së Kuvendit nuk ka kaluar leximin dytë, dhe sipas rregullores kthehet nga fillimi. Pajtohem që numri i anëtarëve të grupit punues të mos jetë e kufizuar.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në këtë pikë të rëndit të ditës me vota unanime nxori këtë:

VENDIM

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e Forcës së Sigurisë, do të hartojë Projektligjin për Komisionarin e Kuvendit për Forcën e Sigurisë dhe Policinë e Kosovës. Themelohet grupi i punës në këtë përbërje: Rexhep Selimi, kryesues, Ganimete Musliu, Anton Quni dhe Qerim Bajrami, anëtarë. Komisioni do të bashkëpunojë me të gjitha institucionet, si dhe mekanizmat e tjerë për hartimin e këtij Projektligji.

Kryetari- Ndërsa sa i përket mbikëqyrjes së Ligjit për Policinë, propozoi që kryesues të jetë z. Nuredin Ibishi, ndërsa për anëtar nuk do të ketë kufizim, por propozoi z. Zafir Berisha dhe z. Qerim Bajrami, z. Rexhep Selimi, ndërsa me z. Anton Quni do të diskutojmë kur të jetë prezent, nëse dëshiron të jetë pjesë e këtij grupi punues.

Komisioni për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrje të FSK-së, në këtë pikë të rëndit të ditës me vota unanime nxori këtë:

VENDIM

Formohet Grupi punues për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit nr. 04/L-076 për Policinë ë Kosovës. Grupi punues ka këtë përbërje: Nuredin Ibishi, raportues, Zafir Berisha, Qerim Bajrami dhe Rexhep Selimi, anëtarë.

4. Të ndryshme

Kryetari- I njoftoi për vizitën e realizuar në Brigadën e Reagimit të Shpejtë të FSK-së në Istog, dhe gjate kësaj vizite në takimin me stafin komandues të Brigadës kemi parë një nivel të lartë të përgatitjes së pjesëtareve të kësaj Brigade dhe gatishmërinë e tyre për marrjen përsipër të obligimeve shtesë në të ardhëm.

Ndërsa, si Komision, propozoi që vizitën e radhës ta realizojmë në Akademinë e Sigurisë Publike në Vushtrri. Gjithashtu ju njoftoi se sa i përket vizitës e cila është paraparë në Gjermani, e cila do të mbështet nga DCAF, ka ndodhur ndryshim në datë, ku është propozuar data 17 maj 2015 për të udhëtuar. A jeni dakord për këtë periudhë?

Rexhep Selimi- Pajtohem vetëm nëse është në dijeni edhe organizatori për këtë ndryshim.

Kryetari- Kjo ka qenë edhe propozim nga ana e organizatorit.

Mbledhja përfundoi në orën 11:30.

Përgatitur nga:

Njësia për Mbështetjen e Komisionit.

Kryetari i Komisionit,

Daut Haradinaj